



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilijano / Prodato Received / Delivery	29.07.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPANSACK	4426/2022		1/6



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.552/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.552/2022 të datës 21.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi undër Vendimit me Nr.11/2022 të datës 25.05.2022 të Komisionit të Pranimit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.552/2022 e datës 21.06.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Anulohet** Vendimi me Nr.11/2022 i datës 25.05.2022 i Komisionit të Pranimit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas si dhe **anulohet** Akti i Renditjes përfundimtare të kandidatëve me numër protokolli 211-03/1 i datës 25.05.2022 për grupin e pozitave "Specialist Ligjor"-Zyrtar Ligjor 2, në Zyrën Rajonale në Dragash.
- III. **Mbetet në fuqi** Akti i Renditjes përfundimtare të kandidateve me numër protokolli 203-03/1 i datës 19.05.2022 për grupin e pozitave "Specialist Ligjor"-Zyrtar Ligjor 2, në Zyrën Rajonale në Dragash.
- IV. **Obligohet** Udhëheqësi i Njëjesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas që të shpall kandidatin fitues duke u bazuar në Renditjen përfundimtare të kandidateve

fitues me numër protokolli 211-03/1 të datës 19.05.2022 dhe të njëjtit t'i lëshoj aktin e emërimit sipas kushteve të parapara ligjore.

**V. Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme ligjore lidhur me zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

**VI.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi kandidat për shërbim civil, më datë 21.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3595/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.11/2022 të datës 25.05.2022 të Komisionit të Pranimit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, me pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vlerësim jo real të kriterëve të konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Ndërsa Këshilli më datë 30.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me këtë çështje.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses me numër protokolli 3595/2022 të datës 21.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me Nr. Referencës RN00008539 i datës 03.03.2022 për Specialit Ligjor-Zyrtar Ligjor 2 i shpallur nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas; Lista e verifikimit paraprak e datës 27.04.2022; Njoftim për rezultatet për ankuesin; Njoftim për intervistë me gojë për ankuesin; Renditjen përfundimtare të kandidatëve i datës 19.05.2022; Ankesën e datës 23.05.2022 nga Vendimi me Nr.11/2022 i datës 25.05.2022 i Komisionit të Pranimit në kuadër të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas; Renditjen përfundimtare të kandidatëve i datës 25.05.2022; Kërkesë për qasje në dokumente publike e datës 01.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.06.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 29.06.2022; Vendimin me Nr. 03/2022 i datës 02.02.2022; Vendimin me Nr.61/2021 i datës 07.12.2021 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Lista e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Ankesën e datës 26.04.2022 nga Ankesën e datës 26.04.2022 nga Vendimin me Nr. 15/2022 i datës 27.04.2022 për refuzimin e ankesës së kandidatës Vendimin me Nr. 14/2022 i datës 27.04.2022 për refuzimin e ankesës së kandidatës e-mailin e datës 08.04.2022 nga për Info lidhur me verifikimin paraprak i datës 28.04.2022; Njoftim për intervistë me gojë i datës 12.05.2022; Procesverbalin e datës 25.05.2022 të Komisionit të Pranimit; Njoftimin përmes emailit të datës 25.05.2022 për ankuesin dhe kandidatën Aplikacionin e kandidatës Diplomën me Nr. 75 të datës 16.12.2015 të Vërtetimin Vr.Nr.233/2022 i datës 14.03.2022, Vërtetimin e datës

21.02.2022, Certifikatën e datës 22.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prizren; Aplikacionin e ankuesit i datës 29.03.2022: Diplomën me Nr. 379 të datës 16.11.2017 për ankuesin, kontrate punë për kohë të caktuar, kontratë pune për kohë të caktuar e datës 25.11.2020, Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 01.05.2018, Vërtetimin e datës 04.06.2020, Vërtetimin e datës 28.03.2022; Vërtetimin e datës 29.05.2018, Certifikatën për periudhë 15.02-15.05.2019, Certifikatën për periudhën 13-14.03.2018, Certifikatën e datës 01.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega Dragash; Aplikacionin e kandidatës e datës 29.03.2022: Diplomën me Nr.1080 e datës 07.03.2011 dhe Diplomën me Nr. 969 e datës 28.10.2015, Certifikatën për periudhë 05-08.12.2017, Certifikatën për periudhën 22-23.11 dhe 04-05.12.2017, Certifikatën prill 2014, Certifikatën për periudhën 18-19.12.2017, Certifikatën për periudhën 14-15.12.2017, Letër Referencë e datës 26.11.2019 dhe 03.12.2019, Letër Rekomandim i datës 14.03.2014, Vërtetim i marrëdhënies së punës i datës 01.06.2021, Vërtetim i datës 30.09.2014 dhe 12.03.2014.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoi së janë të bazuar pretendimet ankimore të ankuesit  
**SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Agjencia për Ndihmë Juridike Falas më datë 03.03.2022 ka publikuar Konkursin me numër reference RN00008539, për grupin e pozitive "*Specialist Ligjor*" gjegjësisht "*Zyrtar Ligjor 2*" në Zyrën Rajonale në Dragash-Suharekë, i hapur për aplikim nga data 28.03.2022 deri më datë 11.04.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili është përfshirë në të gjitha fazat e kësaj procedure rekrutimi

Komisioni i pranimit pas vlerësimit të testit me shkrim, intervistës me gojë dhe jetëshkrimit, më datë 19.05.2022 ka përgatitur Renditjen përfundimtare të kandidatëve sipas së cilës ankuesi është vlerësuar me 56 pikë në testin me shkrim, 17.6 pikë në jetëshkrim dhe 6.4 pikë në intervistë gojore, duke arritur gjithsej tetëdhjetë (80) pikë. Kundër kësaj renditje kandidatja më datë 23.05.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit me pretendimet për mos vlerësim të drejtë të jetëshkrimit konkretisht të certifikatës së trajnimeve, ndërsa Komisioni i Pranimit më datë 25.05.2022 ka nxjerr Vendim me Nr.11/2022 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankueses duke e obliguar Komisionin e Pranimit të bëjë rivlerësimin e jetëshkrimit të kandidatës me arsyetimin se në dosjen e saj është evidentuar dëshmi e ndjekjes së trajnimeve.

Pas këtij vendimi, Komisioni i Pranimit me datë 25.05.2022 ka përgatit Renditjen e re përfundimtare duke ndryshuar pikët e vlerësimit tek jetëshkrimi i kandidatës nga 15 pikë në 16.2 pikë, me ç'rast si rezultat i këtij veprimi kandidatja në fjalë është renditur e para me gjithsej tetëdhjetë e një (81) pikë, ndërsa ankuesi si kandidati i dytë më gjithsej 80 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.11/2022 të datës 25.05.2022 të Komisionit të Pranimit në kuadër të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, pretendon që Komisioni i Pranimit nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë për faktin që kundër kandidatja sa i përket trajnimeve nuk ka dorëzuar ndonjë certifikatë trajnimi, ndërsa pas kërkesë për qasje në dokument më është ofruar një letër kopje e trajnimit por konsideroj që e njëjta është dorëzuar pas afatit të aplikimit.

Organi i punësimit gjegjësisht Agjencia për Ndhimë Juridike Falas në përgjigjen në ankesë deklaroi se procedura e pranimit është zhvilluar në pajtim me të gjitha dispozitat ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, me tej shton se ankuesi nuk ka bërë ankesë tek ky institucion, nuk qëndron asnjë pretendim i ankuesit dhe se Komisioni i Pranimit pranimin e Certifikatës së trajnimit lidhur me kandidaten Y. Nebiu e ka bërë në pajtim me nenin 90 të LPPA-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pranueshmerinë e ankesës respektivisht përkitazi me përcaktimin e legjitimitetit të ankuesit si palë në procedurë, ju referua nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin theksohet se: *Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike*, ndërlidhur me këtë neni 24 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative...* dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se ankuesi ka legjitimitetin e palës në këtë procedurë sepse si rezultat i nxjerrjes së Vendimit Nr.11/2022 të datës 25.05.2022 të Komisionit të Pranimit, ankuesit i janë cenuar të drejtat dhe interesat e tij juridik pasi që i njëjti sipas Aktit të renditjes përfundimtare të datës 19.05.2022 ka qenë kandidati me i vlerësuar gjegjësisht kandidati me më shumë pikë vlerësimi, kështu që në këtë kuptim dhe bazuar në nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës kandidati i cili arrin me së shumti pikë konsiderohet si kandidat përzgjedhës për pozitën e shpallur.

Bazuar si me lart, pretendimi i organit të punësimit se ankesa e ankuesit është e palejueshme për faktin se i njëjti nuk ka bërë ankesë të brendshme, nuk qëndron, sepse sipas vlerësimit të Kolegjit ky kusht ligjor është konsumuar përmes ankesës së kandidatës lidhur me të cilin dhe është nxjerr vendimi i kundërshtuar me ankesë, kështu që Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.11/2022 të datës 25.05.2022 të Komisionit të Pranimit është e pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit se kopja e certifikatës së trajnimit nga kundër kandidatja është dorëzuar pas afatit të aplikimit, Kolegji nga vlerësimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Konkursi me numër referencës RN00008539 për grupin e pozitive "Specialist Ligjor" gjegjësisht "Zyrtar Ligjor 2" në Zyrën Rajonale në Dragash, ka qenë i hapur për aplikim nga data 28.03.2022 deri më datë 11.04.2022, ndërsa sipas kërkesës për përgjigje në ankesë me numër protokolli 3658/2022 të datës 23.06.2022 kandidatja Y.Nebiu Certifikatën e datës 06.11.2013 lidhur me ndjekjen e trajnimit "Academy Writing Career Development Presentation Skills Research Methodology", e ka dorëzuar përmes emailit me datë 17.05.2022 e cila si e tillë nuk është pranuar nga Njësia e Burimeve

Njerëzore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas. Po nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidatës të datës 31.03.2022, Kolegji ka gjetur së e njëjta nuk e ke evidentuar këtë trajnim në formularin e aplikimit dhe po ashtu nuk e ka të bashkangjitur si provë dokumentin gjeësisht certifikatën e trajnimit të datës 06.11.2013, rrjedhimisht, nisur nga faktet si me sipër Kolegji konstaton së Komisioni i Pranimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.11/2022 i datës 25.05.2022, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale ligjore, pasi që në kuptim të nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës kandidati është i obliguar që me rastin e aplikimit përveç dëshmime lidhur me kriteret e konkursit duhet të dorëzoj edhe dëshmitë lidhur me trajnimet e kryera, apo kualifikimet dhe specializimet tjera profesionale, kështu që në kundërshtim me këtë bazë ligjore Komisioni i Pranimit arrin që të njohë një dokument të pa pranuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe të dorëzuar pas përfundimit të të gjitha fazave të procedurës së rekrutimit respektivisht pas testit me shkrim të mbajtur me datë 10.05.2022, vlerësimit të CV-së dhe intervistës me gojë të mbajtur me datë 16.05.2022.

Ashtu si u tha me sipër, Kolegji vlerëson së është i pa bazuar pretendimi i Menaxherit të Personelit në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas se prova shtesë është marrë parasysh nga Komisioni i pranimit duke u mbështetur në nenin 90 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, përkatësisht ndërlidhur me këtë fakt Kolegji konstatona së dispozitat e nenit 90 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative i referohen rasteve ku sigurimi i një provë relevante është i vështirë apo i pamundur, ndërsa organi i punësimit me asnjë dokument nuk ka arrit të arsyetoj së sigurimi i provës një fjalë ka qenë i pamundur gjatë zhvillimit të kësaj procedure pranimit.

Në vështrim të dispozitave të 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative një akt administrative i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore konsiderohet akt juridikisht i pavlefshëm, andaj pas vlerësimit së Vendimi me Nr.11/2022 i datës 25.05.2022 i Komisionit të Pranimit në kuadër të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas është përfshirë me shkelje të legjislacionit mbi pranimin në shërbimin civil, Kolegji konstaton së akti i renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 25.05.2022 i nxjerrë mbi bazën e vendimit të kundërshtuar me ankesë, konsiderohet akt i pavlefshëm dhe si i tillë nuk prodhon asnjë pasojë juridike, kështu që, mbi këto arsye mbetet në fuqi Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 19.05.2022, ndërsa obligohet Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas që të veprojnë në pajtim me pikën IV të diapozitivit të këtij vendimi.

Për vendosje të drejtë dhe meritore, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dokumentacionin e aplikimit të ankuesit në kuptim të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara me Konkursin me numër referencës RN00008539, e sipas të cilit si kriteret e përgjithshme formale janë venë: *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare, Fakulteti Juridik të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, Përvoja pune : së paku 2 vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit,* përkatësisht, ankuesi lidhur me kriterin e arsimit posedon Diplomën me numër 379 të datës 16.11.2017 të lëshuar nga Universiteti " Ukshin Hoti" në Prizren me të cilën vërtetohet së i njëjti ka përfunduar studimet me datë 01.11.2017 në Fakultetin Juridik dhe ka marr titullin Bachelor në Juridik me gjithsej 240 pikë/ECTS, ndërsa lidhur me kriterin e përvojes së punës ankuesi posedon: Vërtetimin e datës

29.05.2018 të lëshuar nga Menaxheri i Personelit të Komunës së Dragashit sipas të cilit ankuesi ka kryer praktikën në këtë institucion nga data 20.11.2017 deri me datë 20.05.2018, Vërtetimin e datës 04.06.2020 të lëshuar nga personi përgjegjës në biznesin sipas të cilit ankuesi ka punuar në këtë biznes si punëtor administrativ në kohëzgjatje nga data 01.05.2018 deri me 30.05.2020 dhe si dëshmi shtesë lidhur me këtë përvojë pune ka prezantuar Pasqyrën e Trustit të datës 05.04.2022, kurse sipas Kontratës së punës për kohë të caktuar të datës 03.08.2020 dhe 04.11.2020 e lidhur me Komunën e Dragashit rrjedhë së ankuesi ka punuar në Komunën e Dragashit nga data 03.08.2020 deri me 04.02.2021 i angazhuar në detyra dhe punë të natyrës juridike dhe sociale, andaj sipas këtyre dëshmive Kolegji konstaton së ankuesi ka plotësuar kriteret për këtë pozitë dhe se i njëjti sipas Renditjes Përfundimtar të datës 19.05.2022 të Komisionit të Pranimit është vlerësuar si një nga kandidatet me më shumë pikë.

Theksuar si me lartë, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.552/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*[Signature]*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

